



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0413

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Panelist Individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) JAGUAR SECURITY SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi Komunal i Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1, me 08.07.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE JAGUAR SECURITY SH.P.K. me nr. 2025/0413, e datës 27.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Kuvendi Komunal i Klinës, ndërkaj aktiviteti i prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik JAGUAR SECURITY SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 12.03.2025 Kuvendi Komunal i Klinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1.

Me 23.05.2025, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë OE TFS Group SHPK.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës shërbim, me vlerë të parashikuar të kontratës 31,454.40 euro.

Me 25.05.2025 OE JAGUAR SECURITY SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 26.05.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.05.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE JAGUAR SECURITY SH.P.K., me numër protokolli 2025/0413 lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues JAGUAR SECURITY SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet Ankimore të Operatorit Ekonomik ankues janë se janë shkelur dispozitat ligjore si në vijim:

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092.

Neni 1 - Qëllimi,

Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve,

Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës, Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik:

Neni 27 (Kriteret e dhënies së kontratës)

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik,

Neni 40 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Si palë me interes konform Nenit 4.1.26 të LPP-së, si palë e pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së (Rivlerësim) të datës 23.05.2025, dhe vendimit të AK-së për kërkesën për rishqyrtim të datës 26.05.2025, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 64 par.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik paraqesim këtë:

A N K E S Ë

Të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 23.05.2025 për rekomandimin për dhënie të kontratës, si dhe ri-vlerësimit të gabuar të ofertave të cilat nuk janë krahasuar dhe ekzaminuar sipas Nenit 59.4 të LPP-së sipas kërkesave të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë, konform Nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 64 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paraqesim këtë "Ankesë" ndaj aktivitetit të prokurimit me titull: Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me nr.prokurimi: 634-25-1784-2-2-1 e inicuar nga Kuvendi Komunal i Klinës.

Për shkak se: Kuvendi Komunal i Klinës Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar operatorin ekonomik, i cili nuk ka plotësuar kërkesat dhe kriteret e aktivitetit të prokurimit me të dhënat e lartëcekura, si dhe ka eliminuar kompaninë tonë pa të drejtë.

Autoriteti Kontraktues ka ra në kundërshtim e dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik duke mos bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të tenderit.

Me datën 24.04.2025 Autoriteti Kontraktues në platformën e E-prokurimit fillimisht kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, të pakënaqur me këtë vendim ne si operator ekonomik kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues me datën 28.04.2025, ku kemi paraqitur pretendimet tona ankimore. Me datën 30.04.2025 Autoriteti Kontraktues ka marr vendim duke aprovuar kërkesën tonë për rishqyrtim duke e dërguar për Rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit.

Provë: Kërkesa për rishqyrtim e datës 28.04.2025, Provë: Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim e datës 30.04.2025.

Në bazë të gjendjes faktike, me rastin e ri-vlerësimit të ofertave konform Nenit 59 të LPP së dhe Nenit 40 të Rregullores Nr.001/2022 të PP-së ne jemi diskriminuar gjatë vlerësimit, pasi që ofertat nuk janë trajtuar njëjtë me vetë faktin se operatori ekonomik i rekomanduar me këtë rast është favorizuar dhe nuk mund të quhet trajtim i barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së, por diskriminim total, dhe jo i drejtë. Autoriteti Kontraktues nuk iu është përgjigjur të gjitha pretendimeve tona ankimore sipas Nenit 108/A par. 9 dhe par.12 të LPP-së me rastin e marrjes së vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.05.2025.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillur Nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që nuk ka rrespektuar kursimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, por e rekomandon një operator ekonomik më të shtrenjtë se oferta jonë në shumë prej 7,454.40 euro, njëjtë si në herën e parë.

Kompania jonë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK-së është eliminuar në arsyetim: Në ofertën tuaj nuk keni llogaritur 5% të kontributeve të punëdhënësit, nuk keni llogaritur pushimet në rast

të zëvendësimeve në analizë financiare. Kjo kërkesë nuk ka qenë e paraparë as në Njoftimin për kontratë e as në Dosjen e tenderit tek ky aktivitet i prokurimit, që të llogaritet 5% shtesë e ndonjë kontributi tjetër. Poashtu askund nuk kërkohet që të llogariten pushimet në rast të zëvendësimeve, e as nuk ka qenë ndonjë kusht specifik tek Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme që në Analizë financiare të parashihet edhe ndonjë pushim i punëtorëve.

Kompania jonë iu është përgjigjur të gjitha kërkesave të AK-së duke rrespektuar kërkesën e specifikuar për pagat në dosjen e tenderit përkatësisht tek Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme ku është kërkuar paga bruto në muaj prej 434.00 euro.

Analiza financiare është përpiluar konform Kalkulatorit online të ATK-së:

<https://crrmm.atk-ks.org/sq/Public/CalculatorDetail?id=21>.

Llogaritja e pagës prej 434.00 euro nga BRUTO NË NETO është bërë sipas Ligjit Nr. 08/L-142.

Kërkesa e Njoftimit për kontratë dhe Dosjes së tenderit 9.1&9.2

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 3. Deklatara që OE do ketë apo do punësoj numrin e kërkuar me Pagat e specifikuar në Dosje të tenderit si dhe kualifikimet e tyre.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Deklaratë me shkrim të vërtetuar që OE ka pranuar Pagat e specifikuar dhe numrin e të punësuarëve. E vërtetuar dhe nënshkruar nga Personi përgjegjës.

Kompania jonë ka bashkangjitur deklaratën me shkrim të vulosur dhe ka pranuar pagat e specifikuar dhe numrin e të punësuarëve në rast të rekomandimit të kontratës, pra kërkesa juaj është përmbushur me dëshmi nga ana e kompanisë sonë.

Kërkesa: Operatori Ekonomik të paraqet analizën financiare

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Analiza financiare e detajuar.

Kompania jonë ka bashkangjitur analizën financiare poashtu në Analizën financiare ka bashkangjitur edhe një deklaratë ku kemi potencuar se do ti rrespektojmë të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 duke përfshirë shtesat të cilat i takojnë sipas Nenit 32 dhe 56 të po këtij ligji, pra kërkesa juaj është përmbushur me dëshmi nga ana e kompanisë sonë.

Sa i përket mënyrës së organizimit të pushimeve si ato "vjetore" dhe "mjekësore" kjo kërkesë nuk ka qenë e paraparë në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirëpo kompania jonë në deklaratën e saj e ka përfshirë pjesën e pushimit sipas Ligjit dhe kjo është çështje e brendshme e organizimit të kompanisë. Ne kemi numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë punëtor "pilot" të cilët angazhohen gjatë pushimeve të punonjësve tanë.

Poashtu nëse e analizojmë punën e pushimeve të punëtorëve të sigurimit fizik atëher "të gjitha shkollat në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it për kalendarin e vitit shkollor 2024-2025 që ka për qëllim të përcaktojë fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor 2024/2025 në të gjitha institucionet publike dhe private" tregon se sa ditë pushimi kanë dhe si bëhet mënyra e organizimit të pushimeve, andaj gjatë muajit Qershor-Gusht shkollat nuk kanë mësim dhe gjenden në pushime, andaj koha kur shkollat nuk punojnë punëtorët kanë mjaftueshëm kohë të kryejnë pushimet vjetore të cilat do ti kenë me pagesë.

Autoriteti Kontraktues "Kuvendi Komunal i Klinës" ka pranuar kërkesë për rishqyrtim nga një operator ekonomik me datën 24.03.2025, duke e atakuar vlerën e parashikuar të kontratës e cila në fillim ka qenë në shumë më të ulët dhe Autoriteti Kontraktues me datën 25.03.2025 ka aprovuar kërkesën e operatorit ekonomik ankues si të bazuar duke bërë rritjen e vlerës së parashikuar të kontratës në shumë prej 61,454.40 euro.

Llogaritja është mjaftë e thjeshtë: Vlera e parashikuar e kontratës 61,454.40 euro / 24 muaj = 2,560.60 euro muaji / 5 punëtor = 512.12 euro (paga bruto tvsh) për një punëtor 434.00 euro paga bruto x 5 punëtor = 2,170.00 euro 2,170.00 euro pagat bruto x 18% tvsh = 2,560.60 euro. Në bazë të këtij kalkulimi vlera e ofertës sonë është po aq sa është paraparë vlera e parashikuar e kontratës nga Autoriteti Kontraktues. Ne kemi rrespektuar kërkesën e AK-së "Ju lutemi të respektoni këtë kufi minimal gjatë procesit të llogaritjes dhe ekzekutimit të pagave".

Bazuar në Nenin 40.12 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik e cila përcakton: 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit", si dhe Neni 45.24 thuhet: Bazuar në nenin 56.3 të LPP, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dosjen e tenderit

Neni 40.2 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Neni 40.13 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Citoj dispozitën Neni 40.2. Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Pra Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar konform Nenit 59.4 të LPP-së dhe Nenit 40.2 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak se në vlerësim të ofertës sonë kanë shtuar kërkesa të reja që paraprakisht nuk kanë qenë të cekura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit.

Sipas Nenit 1 të LPP-së, Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët

ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Nga po e njejta dispozitë ligjore thuhet se ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Citoj dispozitën e Nenit 60 të LPP-së: 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 të LPP së pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të këtij neni me rastin e marrjes së Vendimit për dhënie të kontratës për OE i cili për nga çmimi është shumë më i lartë, pra AK nuk ka rrespektuar Kriterin për dhënie të kontratës.

Kompania jonë ka ofertuar më lirë se kompania e rekomanduar për kontratë në shumë prej 7,454.40 EUR, kështu që është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës. Andaj konsiderojmë se një kërkesë e tillë e pacekur është në kundërshtim me Nenin 7.2 të LPP-së ku thuhet: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik".

Neni 7.4 i LPP-së thotë: "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik". Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues ti trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjor të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Të gjitha kërkesat janë të bazuara në Ligjin nr. 03/L-212 dhe në obligimet tjera tatimore sipas ligjeve në fuqi. Kontributet duhet të llogariten ashtu siç parashihen me ligj: 5% nga punëdhënësi dhe 5% nga punëtori, si dhe obligimet tjera (tatimi në pagë dhe TVSH).

Sa i përket pushimeve vjetore, ato duhet të llogariten sipas Ligjit të Punës dhe të përfshihen në analizën financiare, pasi paraqesin obligime të punëdhënësit. Kemi theksuar se duhet të kalkulohen të gjitha obligimet ligjore.

Sigurimi i shkollave duhet të ofrohet për 12 muaj të vitit, pavarësisht pushimeve vjetore të shkollave – sigurimi duhet të jetë aktiv gjatë gjithë vitit. Në rastet kur punëtorët janë në pushim vjetor, duhet të angazhohen punëtorë zëvendësues, të cilët duhet të paguhen.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë

shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0413, ndërsa me datë 10.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0363, me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e JAGUAR SECURITY SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0413 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1.

Sipas pretendimi ankimor nr. 1, OE ankues pretendon si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se në baë të letrës standarde mbi tenderuesin e eliminuar Operatori Ekonomik ankues është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit si i pa përgjegjshëm me arsyetimin si në vijim:

“Në ofertën e juaj nuk keni ofruar dëshmi sipas kërkesës së dosjes se tenderit tek Analiza financiare: Nuk e keni paraparë 5%-shin e kontributit nga punëdhënësi për punëtorët dhe pushimet”.

Sqarojmë se kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me këtë është:

Kërkesa:

Operatori Ekonomik të paraqet analizën financiare

Dëshmia:

Analiza financiare e detajuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se në rastet e tilla kur kërkohen analiza të tilla financiare autoriteti kontraktues me qëllim të lehtësimit dhe qartësimit të operatoreve ekonomik duhet autoriteti kontraktues të përgatit vetë analizën e tillë financiare dhe të i përfshijë të gjitha elementet e shpenzimeve që duhet të i përfshijë një analiza financiare të zbatimit të kontratës sipas ligjeve në

fuqi ne Kosovë (Ligji per Administrimin e Procedurave Tatimore, Ligji i Punës , etj) ndërsa operatorët ekonomik duhet te i plotësojnë vetëm çmimet ne analizë. Si rrjedhojë e mungesës se nje analize te tillë ne dosje te tenderit atëherë secili operator ekonomik ka plotësuar analizën ne mënyrën e vetë dhe kjo ka krijuar paqartësi dhe pakënaqësi tek operatorët ekonomik te eliminuar duke përfshirë secili operator shpenzime te ndryshme në analizën financiare

Autoriteti Kontraktues sipas Neni 31 Ekzekutimi i kontratave saktësisht paragrafi 1 mund të vendosin kërkesa të veçanta në lidhje me mënyrën se si kontrata duhet të ekzekutohet me kusht që kërkesat mos të shkelin parimet e Nenit 7 dhe janë paraqitur në dosjen e tenderit.

Mungesa e nje analize te mirëfillt financiare në dosje te tenderit është ne kundërshtim me paragrafin 1 te nenit 31 te LPP-së dhe Autoriteti Kontraktues është dashur te vendos analizën fiandciare me te gjitha elementet apo zërat e shpenzimeve dhe ne këtë menyre operatorët ekonomik te plotësojn këto analiza me vendosjen e çmimeve.

Operatori Ekonomik ankues ne këtë rast ka dorëzuar dokumentin te renditur nr. 12 ku përfshin deklaratën mbi pagën minimale sipas kërkesës se dosje se tenderit dhe po ashtu ka dorëzuar edhe analizën si në vijim: të bashkëngjitur gjeni tabelen në raportin e ekspertit shqyrtues.

Nga tabela e mësipërme rezulton se Operatori Ekonomik Ankues (Jaguar Security shpk) ka plotësuar tabelën ku paraqitet paga bazë 434.00€ dhe duke shtuar edhe elementet shtesë te cilat e rrisin pagën bazë plus TVSH ne vleresn prej 512.12€.

Nga kjo nuk mund te paragjykohet qe operatori ekonomik ankues ne vlerën totale bruto nuk ka përfshirë kontributin pensional prej 5% e kontributit nga punëdhënësi për punëtorët dhe pushimet. Zbatimi i kontratës ne pjesen e pagesës se kontributeve pensionale dhe respektimit te te drejtave te punëtorëve është në fushëveprimin e Inspektoratit te ATK-së dhe Inspektoratit te Punës.

Autoriteti kontraktues ne dosjes tenderit ka vendosur çmimin e planifikuar ne vlerën prej 61,545.00€ ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar per kontratë ka ofertuar me çmimin total prej 68,908.00€ pra kemi te bëjmë me një ofertë prej 7,383.00€ mbi buxhetin e planifikuar nga Autoriteti Kontrakues.

Andaj, bazuar në përshkrimin e mësipërm lidhur me analizën financiare, ku mungojnë informacionet në dosjen e tenderit, dhe duke marrë parasysh Nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP) – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Nenin 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, si dhe Nenin 40.2 të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2024, rekomandoj që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Sipas përshkrimit të bërë më sipër, shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit, dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore të ankuesit, analizave financiare të operatorëve ekonomikë, sqarimeve shtesë të dhëna nga Autoriteti Kontraktues, si dhe bazuar në Nenin 6 të Ligjit për Prokurim Publik – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, eksperti shqyrtues rekomandon panelin shqyrtues që të anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues nr. i datës 23.05.2025 mbi dhënien e kontratës, dhe që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, duke marrë për bazë përshkrimin dhe arsyetimin e mësipërm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike E-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me

këtë aktivitet të prokurimit konstatojm qe ankesa e OE ankues te konsiderohet si e bazuar.

Është përgjegjësi të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore te LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore te operatorit ekonomik ankues, dosjes se tenderit, nenit 6,7, 59 te LPP-së eksperti shqyrtues rekomandon panellin shqyrtues qe te Anullohet Vendimi i AK-së i datës 23.05.2025 mbi dhënie e kontrates dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në RI-Vlerësim duke marr per bazë përshkrimin dhe arsyetimin e mësipërm.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi fizik në shkollat e Komunës së Klinës me numër të prokurimit 634-25-1784-2-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashitjet dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - JAGUAR SECURITY SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: